



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Nr. 01-112/01-3013

Datë: 16.01.2026

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 pika (b) të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 35 të Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin numër 08/L-294, nenin 9 të Ligjit numër 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publik, me qëllim të mbarëvajtjes së punëve në Sektorin për Statistika, Administratë dhe Infrastrukturë Arsimore, me datë 16.01.2026 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Nëpunësja **Liridona Lluka**, e sistemuar në punë Zyrtar i Lartë për Burime Njerëzore, **caktohet ushtruese e detyrës së Udhëheqësit të Sektorit për Statistika, Administratë dhe Infrastrukturë Arsimore**, që të punoj me kompetenca të plota, sipas koeficientit **7.26 (GJ3)** duke filluar nga data **19.01.2026**.
2. E emëruara si në pikën 1 të këtij vendimi, ushtron detyrat dhe përgjegjësitë si më poshtë:
 - 2.1. Udhëheqë punën e gjithmbarshme të sektorit, menaxhon me stafin e sektorit dhe bën ndarjen e detyrave tek varësit e saj, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit për të siguruar produkte dhe shërbime cilësore deri në përmbushjen e planit të punës dhe objektivave të përcaktuara. Gjithashtu, bën vlerësim të rregull të stafit nën mbikëqyrje të saj dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimeve për të siguruar kryerjen e detyrave të tyre në nivel me standardet e kërkuara.
 - 2.2. Regjistrimin e të dhënave personale për nxënës, sipas formularit të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe të gjitha statistikat e nevojshme në arsimin para universitar.
 - 2.3. Mirëmbajtjen dhe riparimin e ndërtesave dhe pajisjeve të institucioneve arsimore me fonde publike, si dhe sigurimin e dispozitave për mirëmbajtje të shërbimeve mbështetëse për mirëqenien fizike të nxënësve, duke përfshirë ujë të freskët, ambiente banjash dhe shërbime shëndetësore.
 - 2.4. Marrjen e masave për të siguruar që ambienti rrethues urban apo rural në të cilin është e vendosur shkolla, është në përputhje me të drejtën e nxënësve për të pasur një mjedis të sigurt në oborin e shkollës.
 - 2.5. Adreson te Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës njoftimet e pranuar nga shkollat për pagën dhe të drejtat në pagë për secilin të punësuar në arsimin para universitar.
 - 2.6. Në koordinim me Sektorin për Menaxhimin e Kontratave dhe Zhvillim të Projekteve, monitoron hartimin e planit për menaxhimin e kontratave duke përfshirë çështjet e aspekteve organizative, ekonomike, teknike dhe ligjore, ekipet e menaxhimit të projekteve, rishikimin e ekzekutimit të kontratës, protokollat për dorëzimin e pajisjeve të autorizuar, dialogun e rregullt me kontraktuesit, përdorimin e standardeve korrekte të cilësisë, menaxhimin e pagesave/kërkesave, procedurat e ankesave, mjetet e kontrollit të specifikuar në kontratë, dhe sigurimin e ekzekutimit për defekte/korrigjim në arsimin para universitar.

- 2.7. Përditësimin e pasurisë dhe menaxhimin e regjistrit të pasurisë për gjithë arsimin para universitar në Komunën e Gjakovës.
3. Zyrtari publik nuk mund të caktohet si ushtrues detyre më gjatë se dymbëdhjetë (12) muaj përveç rasteve kur procedura e rekrutimit është shpallur por për arsye objektive pozita nuk është plotësuar. Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se një periudhë prej dy (2) viteve. Çdo vendim i marrë nga ushtruesi i detyrës pas kalimit të afatit të përcaktuar është i paligjshëm.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës



Vendimi iu dorëzohet:

- Nëpunëses Liridona Lluka
- Drejtorisë për Arsim
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
- Arkivit